

GNPIE – Kapitulli 8 “Politika e Konkurrencës”

Kapitulli 8 “Politika e Konkurrencës” është pjesë e Grupkapitullit të dytë “Tregu i Brendshëm” në kuadër të negociatave për anëtarësim në Bashkimi Evropian. Ky kapitull përfshin katër nënfusha kryesore: antitrust, përqendrime, ndihma shtetërore dhe liberalizimi.

Autoriteti i Konkurrencës është institucioni lider për këtë kapitull dhe koordinon punën ndërinstitucionale. Në këtë proces kontribuojnë gjithashtu 10 institucione:

- Ministria e Financave
- Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
- INSTAT
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Qendra Kombëtare e Kinematografisë

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 749/2018, janë ngritur Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE), përmes Urdhrit të Kryeministrit nr. 94, datë 20.05.2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian”.

Këto grupe krijohen për secilin kapitull të acquis dhe kryejnë analiza të detajuara mbi:

- politikat dhe legjislacionin,
- financimin,
- procedurat administrative,
- ndërveprimin me aktorët e tregut,
- si dhe zbatimin institucional në fushën përkatëse.

Në vijim të këtij procesi analitik, GNPIE përkatëse harton “Planin e Veprimit të Kapitullit”, duke përgatitur gjithashtu Qëndrimet Paraprake dhe Qëndrimet Përfundimtare. Këto dokumente

shërbejnë si bazë për zhvillimin e negociatave me Bashkimi Evropian dhe sigurojnë përputhshmërinë me dokumentet strategjike kombëtarë.

Autoriteti i Konkurrencës organizon në mënyrë periodike takimet e GNPIE-së, ku institucionet pjesëmarrëse kontribuojnë me ekspertizën e tyre për të avancuar përafrimin me acquis, për të forcuar zbatimin efektiv të rregullave të konkurrencës dhe për të siguruar koordinimin e punës në nivel kapitulli.